

Prof. dr. Muhamed MUFAKU

IMAZHI I LIDHJES SË PRIZERENIT NË LINDJEN E MESME 1978-2008

Kjo kumtesë ka të bëjë me një fushë pak të prekur : imazhi i Lidhjes së Prizrenit në botën jo shqiptare të kohës sonë, përkatësisht në veprat e historianeve të ndryshëm që zakonisht merren si burim për krijimin e imazhit për tjetrin.

Në këtë kumtesë preken ca elemente që ndikojnë në punën e historianëve për të caktuar çka kanë shkruar për Lidhjen e Prizrenit, përkatësisht për ndikimin e elementeve kulturore-politike.

Në Lindjen e Mesme kemi pesë zona të mëdha kulturore politike: turke, kurde, persiane, arabe dhe ebreje. Kuptohet, kjo kumtesë ka të bëjë vetëm me një zonë, zonën arabe, kurse në të ardhmen mbetet të gjurmohet zonat tjera e të krahasohen rezultatet.

Në këtë kumtesë merret parasysh edhe formimi akademik i historianeve që u merren me Lidhjen e Prizrenit, ku po ashtu duken ca ndikime të elementeve kulturore politike. Një shembull të mirë për këtë kemi dy libra që u botuan brenda një kohe të afërt, por që prezantojnë dy imazhe të ndryshme për Lidhjen e Prizrenit. Libri i parë është kopt, i cili ishte në Prishtinë në kuadër të Seminarit Ndërkombëtar për Gjuhën. Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare më 1984. Qëndrimi i tij në Kosovë ndikoi që ai të njihet e të mbështetet në

veprat e historianëve shqiptar (si te Kristo Frashëri etj.). Libri i dytë është ai i irakianit Xhafer Abdula Sahid, që përndryshe është shiit. Ai qëndroi disa vjet në Beograd për studime, dhe si pasojë në librin e tij ai mbështetet në veprat e historianëve serbë (si te Bogumil Hrabak etj.). Pra, këtu lehtë mund të marrim me mend ç' imazhe të ndryshme kemi në këto dy libra. Sa i përket përcaktimit kohor të kumtesës 1978-2008 mund të thuhet se këtu kanë ndikuar ca ngjarje historike-politike si festimi i 100 vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, ku me këtë rast dolën një seri botimesh, anulimi i autonomisë së Kosovës më 1989 me gjithë pasojat e mëvonshme, lufta e armatosur për çlirim më 1998, lufta e vitit 1999 dhe çlirimi i Kosovës, Shpallja e Pavarësisë më 17 shkurt 2008. Të gjitha këto ngjarje e rritën interesimin për Kosovën dhe historinë e saj dhe koincidian me botimin e librave të reja që trajtojnë Lidhjen e Prizrenit.

Kjo kumtesë merret vetëm me librat e botuara brenda një kohe të caktuar (1978-2008), pra nuk merret me studimet e botuara në periodik as me shkrimet e botuara në shtyp gjatë asaj kohe. Brenda kësaj kohe kemi 10 libra të botuara që trajtojnë Lidhjen e Prizrenit pjesërisht ose tërësisht, varësisht prej temave që përfshihen në këto libra. Kështu, këto libra mund të ndahen si vijon:

1. Libra që merren me Ballkanin dhe osmanlinjtë si libri i historianit sirian Dr. Ahmad Hassun "Ballkani dhe osmanlinjtë" që u botua në Bejrut më 1985.¹

2. Libra voluminoze që merren me Perandorinë Osmane, që kanë për hapësirë tërë rajonin e popujve të kësaj perandorie. Shembulli kryesor është libri i historianit të njohur egjiptian Abdu Aziz al-Shannavi "Shteti osman" në katër volume me 2000 faqe i cili u botua në Kajro në vitet 1980-1986.²

3. Libra që merren me lëvizjet për autonomi e pavarësi në Perandorinë Osmane, sikurse është libri i historianit libanez Abdul

1 Ali Hassun, *al-'Uthamijun wa al-Balkan*, Bejrut, 1986.

2 'Abdul' Aziz al-Shinnawi, *al-Dawla al-'uthmaniya dawla muftara 'alijha 1-4*, al-Kahira 1980-1986.

Rauf Sinno "Tendencat autonomiste në Perandorin Osmane" që u botua në Bejrut më 1998.³

4. Librat që merren me Kosovën dhe shqiptarët siç është libri i profesorit irakian Xhafer A. Sahib "Problemi i Kosovës" që u botua në Tripoli më 1998.⁴; libri i Muhamed Mufakut "Kosova epiqendra e konfliktit shqiptari-serb në shek. XX" që u botua në Kajro më 1998.⁵; libri i studiuesit palestinez Muhamed Halifes "Çështja shqiptare në kontekstin ballkanik dhe në kuadrin islamik" që u botua në Gaza më 2000⁶; libri i studiuesit egjiptian Muhamed Jusif Adas "Kosova midis fakteve historike dhe miteve serbe"⁷ si dhe libri i Muhamed Mufakut "Kosova midis të se kaluarës dhe të tashmes" që u botua në Bejrut dhe në Kajro më 2008.⁸

5. Monografi që merren me Lidhjen Shqiptare të Prizrenit sikurse libri i historianit egjiptian A. S. Abdul Sajid "Lidhja Kombëtare Shqiptare ose Lidhja Shqiptare e Prizrenit 1878-1881" që u botua në Kajro më 1986.⁹

Tani shtrohet pyetja: ç'të dhëna kemi në këto libra, ose si duket imazhi i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në këto libra?.

Me përjashtim të librit të prof. Sahib, që përndryshe nuk është historian por profesor në degën e filozofisë, imazhi është pozitiv dhe veçohet me këto elemente kryesore:

3 'Abdul Rauf Sinno, *al-kijanija al-islamija fi al-dawla al-'uthmanija 1877-1881*, Bejrut, 1998.

4 'Xha'far A. Al-Sahib, *Mushkilatu Kosovo*, Tarabulus, 1998.

5 Muhamad M. Al-Arnaut, *Kosovo bu'rat al-niza' al-albani al-sirbi fi alkrin al-ishrin*, al-Kahira, 1998.

6 Muhamad Halifa, *al-Mas'ala al-albanija fi itariha al-islama wa nitakiha al-bal-akoani*, Gazza, 2000.

7 Muhamed Jusuf 'Adas, *Kosova bajn al-hakaik al-tarihija wa al-asatira al-sirbi-ja*, al-Kahiria, 2000.

8 Muhamad M. Al-Arnaut, *Kosova bajn al-madi wa al-hadir*, Bejrut, 2008.

9 Anton Surjal 'Abd al-Sajid, *al-Rabita al-kawmija al-albanija aw rabitat Prizren al-albanija 1878-1881*, al-Kahira, 1986.

1. Trajtimi i Marrëveshjeve se Shën Stefanit si goditje e rënd për shqiptarët, një goditje që kontribuoi në zgjimin e nacionalizmit shqiptar që do të thotë këtu: Bashkimi shqiptar dhe mbrojtja e territoreve shqiptare prej copëtimit dhe aneksimit nga shtetet fqinje si Mali i Zi e Greqia etj.¹⁰

2. Trajtimi i Kongresit të Berlinit si goditje tjetër e rënd kundër shqiptarëve, me çka shqiptarët kaluan nga gjendja passive në gjendjen aktive si Formimi i Lidhjes së Prizrenit dhe formulimi i kërkesës kombëtare) bashkimi i katër vilajeteve në një vilajet me njëfarë autonomie)¹¹.

3. Distancimi i qartë midis dy fazave të Lidhjes së Prizrenit: faza proosmane dhe faza antiosmane.¹²

4. Përpjekja e sulltan Abdul Hamidit II për të shfrytëzuar Lidhjen e Prizrenit për ta penguar zbatimin e vendimeve të Kongresit të Berlinit që të cenohet sa më pak Perandoria Osmane.¹³

5. Gatishmëria e popullit shqiptar për të mbrojtur territorin e vet me armë qoftë kundër forcave osmane ose malazeze.¹⁴

6. Shndërrimi i Lidhjes së Prizrenit, në fazën e dytë, në një qeveri të përkohshme pasi mori në dorë mbledhjen e taksave, rekrutimin e të rinjve, shpërndarjen e armëve, dhe gatishmëria e Lidhjes së Prizrenit për të luftuar kundër ushtrisë osmane nëse kërkonte nevoja.¹⁵

7. Vendosmëria e Stambollit për ta përmbysur me forcë ushtarake Lidhjen e Prizrenit dhe mbrojtja heroike e forcave të Lidhjes.¹⁶

10 Al-Shinnawi, po aty, f. 1877, Sinno, po aty, f. 150-151.

11 Hassun, *al-'Uthmainjun*, f. 26-67.

12 Sinno, po aty, f. 1878.

13 Al-Shinnawa, po aty, f. 1878.

14 Adas, po aty, f. 98-101.

15 Adas, po aty, f. 98-101, Surjal, po aty.

16 Surjal, po aty, f. 86-88. Surjal, po aty, f. 86-88.

8. Mungesa e përkrahjes ndërkombëtare për kërkesat e shqiptarëve, të cilat ndonëse të drejta nuk gëzuan përkrahjen e ndonjë fuqi të madhe të asaj kohe.¹⁷

9. Roli i Lidhjes së Prizrenit në afirmitetin e “çështjes shqiptare” në opinionin arab të kohës në saje të interesimit të shtypit arab të kohës për Lidhjen e Prizrenit.¹⁸

10. Ndonëse u shua me forcë e gjak më 1881, ideali i Lidhjes së Prizrenit mbeti i gjallë në shpirtin e shqiptarëve deri në shpalljen e pavarësisë me 1912.¹⁹

17 Surjal, po aty. f. 89.

18 Nufaku, po aty. f. 26-27.

19 Haifa, po aty. f. 23-24, Surjal, po aty. f. 89.

Prof. dr. Muhamed MUFAKU

SUMMARY

THE IMAGE OF THE LEAGUE OF PRIZREN IN THE MIDDLE EAST 1987-2008

The Albanian League of Prizren has been assessed by many authors of the Middle East. Anyways, the object of this study is the image of Albanian League of Prizren in Arabic literature. Many Arab authors have written on the Albanian League of Prizren. Among which famous Egyptian author Kop and Iraqi author Jaffar Abdullah Sahid.

Egyptian author Kop had expertise on Albanian issue as he was regular participant of seminars organized in Prishtina for Albanian Language and Literature.

This author comes to conclusion that Albanian League has been a reflection of Albanian people's aspiration for national liberation after the Treaty of Saint Stephen and the Berlin Congress endangered their territorial integrity.

Iraqi author Jaffar Abdullah Sahid, who was educated in Belgrade and completely under the influence of the Serbian historiography, has a very subjective and biased approach. He draws conclusion that the movement has been pan-Islamic under arbitrary organization and leadership of Istanbul, thus fighting for territorial integrity of the Ottoman Empire in Balkans. His writings on the Albanian League of Prizren mislead Arabic opinion by distortion of facts and as such hold no scientific value.